



Konferenca: “Praktikat e mira të mësimdhënies: përvojat dhe prespektiva për të ardhmen”

Qyteti i Mitrovicës është një qendër e rëndësishme arsimore në Kosovë. Realizimi i konferencës, për komunitetin arsimor, paraqet një platformë ku pedagogët, akademikët dhe profesionistët e arsimit mund t'i ndajnë praktikatat e mira dhe përvojat e tyre për ta përmirësuar cilësinë e mësimi.

Drejtoria Komunale e Arsimit, në bashkëpunim me partnerin lokal CMG “Consulting and Management Group” përmes kësaj konference synon identifikimin dhe promovimin e praktikave të mira të mësimdhënies dhe të nxëniti.

Qëllimet e Konferencës

- Të prezantohen dhe promovohen praktikatat më efektive të realizimit të orëve mesimore
- Të mësohet nga përvojat e strategjive të suksesshme të mësimdhënies dhe të nxëniti
- Të identifikohen sfidat dhe të gjenden mënyrat për t'i adresuar ato në mënyrë efektive
- Të shtohet bashkëpunimi për të krijuar rrjetin e nevojshëm të arsimtarëve dhe të profesionistëve në arsim

Ftojme të gjithë mësimdhënësit, studiuesit, profesorët universitar, udhëheqësit arsimorë, dhe studentët që të bëhen pjesë e ndërtimit të qëllimeve të konferencës duke marrë pjesë me punimet e tyre.

Temat e Konferencës:

1. Praktikatat e mira mesimore në edukimin e hershëm

- Zhvillimi i aftësive të komunikimit dhe të bashkëveprimit në edukimin e hershëm
- Përdorimi i lojërave edukative për të ndihmuar në zhvillimin e mendimit kritik dhe kreativ të fëmijëve

2. Inovacionet në mësimdhënie në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë

- Zhvillimi i modeleve të mësimi bazuar në projekte për t'i motivuar nxënësit për mësim
- Përdorimi i metodave të mësimi bazuar në zgjedhjen e problemeve për t'i thelluar njohuritë dhe aftësitë analitike të nxënësve
- Integrimi i pajisjeve dhe i aplikacioneve teknologjike në mësim për të rritur përfshirjen aktive dhe për të ndihmuar mësimin e personalizuar. Rritja e shkathtësive të nxënësve për ta përdorë teknologjinë duke synuar krijimin e produkteve dhe projektimit të zgjidhjeve për sfidat aktuale shoqërore dhe mjedisore.

3. Roli i udhëheqjes në rritjen e rezultateve të të nxëniti

- Diskutimi i rolit të drejtuesve dhe udhëheqësve shkollorë në zhvillimin e një kulture të të nxëniti cilësor
- Përfshirja e strategjive dhe praktikave të suksesshme të udhëheqjes që si efekt kanë rritjen e suksesit akademik të nxënësve

4. Njohje të Reja për të Mësuarit Social-Emocional (SEL):

- Diskutimi për teknikat dhe praktikatat e përshtatshme për t'i ndihmuar nxënësit në zhvillimin e aftësive të tyre sociale dhe emocionale
- Përfshirja e përfitimeve të të mësuarit social-emocional në performancën akademike dhe përgatitjen për jetën

Data të rëndësishme

Dërgimi i abstraktit: **deri me 16 shtator** (abstrakti përmban deri në 250 fjalë)

Dërgimi i punimit të plotë: **deri me 6 tetor** (punimi i plotë përmban 2500 fjalë, pa abstrakt dhe referenca)

Data e konferencës: Konferenca mbahet me **1 - 2 nëntor**

Vendi: **Mitrovicë**

Abstraktet dhe punimet dërgohen në e-mail adresën e konferencës: kpmm2024@gmail.com duke shënuar në subjekt të emailit:

Konferenca e praktikave profesionale të mësimdhënësve - Abstrakt nga 'emri dhe mbiemri'

Konferenca e praktikave profesionale të mësimdhënësve - Punim nga 'emri dhe mbiemri'

Informacion i rëndësishëm:

Pas aprovimit të abstrakteve nga ekspertët e fushave, për pjesëmarrësit në konferencë do të organizohet trajnimi “Hulumtimi në veprim”, për t'i ndihmuar mësimdhënësit në hartimin e punimit final.